

Republika Kosova-Republika e Kosovës Republic of Kosovo

Opština Štrpce

Komuna e Shtërpçës

Municipality of Strpce

Në mbështetje të nenit 12, 17, 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, të neneve 10 dhe 34 të Statutit të Komunës së Shtërpçës Nr. 01- 898 të datës 14/07/2010, Kuvendi i Komunës së Shtërpçës në mbledhjen e mbajtur më datën 27/09/2022 miratoi këtë :

V E N D I M

Miraton procesverbal nga seanca e kuvendit e mbajtur me 28.07.2022

- 1. Miratohet procesverbal nga seanca e kaluar e Kuvendit i Komunës sipas tekstit e dhënë në këtë vendim.**
- 2. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryesuesit të Kuvendit Komunal .**

Kryesuesi i Kuvendit

Predrag Grbic





Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republik of Kosovo




Skupstina opštine štrpce

Kuvendi i Komunës së Shtërpçës

Municipality of Strpce

PROCESVERBAL



Nga seanca e pestë e rregullt e KK-ës të mbajtur më 28.07.2022, me fillim në ora 10:00 h.

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i rendit të ditës
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga seanca e kaluar e K. K. Shtërpçës.
3. Dhënia e betimit të këshilltares Ana Milosavljevic
4. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit gjashtëmujor të punës së kryetarit
5. Prezantimi i raportit financiar gjashtëmujor për periudhën janar - qershor 2022 dhe raporti për nivelin e pagesës së hyrave vetanake.
6. Rishqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për funksionimin dhe bashkëpunimin e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe vendbanimet urbane.
7. Shqyrtimi i propozimit të Rregullores për taksat komunale dhe marrja e vendimit për vënien në debat publik të kësaj rregulloreje.
8. Raporti i auditimit të performancës për sistemin e licencimit të hidrocentraleve dhe monitorimi i tyre i ndikimit të tyre në mjedisin dhe ujin
9. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit gjashtëmujor të punës së KKSB-së për vitin 2022
10. Të ndryshme.

Seanca e gjashtë e rregullt e KK të Shtërpçës ka filluar pas konstatimit të kryetarit të Kuvendit, z. Predrag Grbic se të pranishëm ishin 14 këshilltarë dhe para se të fillonte me pikën e parë të rendit të ditës, i njoftoi që këshilltarja znj. Ana Milosavljevic është në vend të z. Ilija Rusimovic sepse

ai ka dhënë dorëheqjen dhe se znj. Ana Milosavljevic për nga numri i votave të fituara, ka qenë menjëherë pas z. Rusimovic në Listën Serbe (Srpska Lista), dhe se në të ardhmen do të jetë deputete e këtij Kuvendi, pas dhënies së betimit, ka përfunduar z. Predrag Grbic. Më pas kaluam në pikën e parë të rendit të ditës:

Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës ku z. Slavisa Vasiljevic theksoi se në mëngjes rreth orës 07:20 Policia e Kosovës dhe Inspektorati nga Ferizaj e kanë hyrë në shtëpinë e tij, ku kanë bërë bastisje, dhe me atë rast ka kërkuar nga Kuvendi dhe të gjithë kolegët këshilltarë që ta dënojnë këtë gjest i policisë. Ai ka thënë se kanë dashur t'i konfiskojnë barnat që i përdor nëna e tij për mjekim dhe se ajo ka 4 diagnoza, të gjitha me pretekstin se nuk kanë akcizë adekuate sepse barnat janë nga Serbia, të cilën e merr me recetë elektronike. Ai vazhdoi duke thënë se urdhri ishte për të kërkuar armë që nuk u gjet dhe se skenat ishin vërtet të pakëndshme. Z. Predrag Grbic tha se kjo duhet të diskutohet në pikën e ndryshme dhe më pas e vendosi në votim rendin e ditës, pasi askush tjetër nuk është lajmëruar për fjalë. Ai u miratua me njëzëri. Menjëherë pas kësaj kaluam në pikën e dytë të rendit të ditës:

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar e KK Shtërpce, ku z. Valmir Ahmeti ka pasur vërejtje në procesverbal lidhur me pyetjen që i ka bërë drejtorit të shëndetësisë, duke ka thënë se pyetja nuk është në procesverbal dhe ka kërkuar që në të ardhmen të mos ketë mangësi të tilla. Më pas z. Arifi kishte një vërejtje, sepse në procesverbal nuk ishte përfshirë pyetja që ai i bëri kryetarit të komunës për rrugën për në Kashtanjevë. Z. Grbic iu përgjigj atyre duke thënë se ato gabime do të korrigjohen dhe më pas kaloi në votim të procesverbalit dhe u miratua me 10 vota "pro", 2 "kundër" dhe 2 "abstenime". Pika tjetër ishte: **Betimi i këshilltares Ana Milosavljevic**, ku ajo mori fjalën dhe bëri betimin me atë rast, pas së cilës kryetari e përgëzoi dhe i uroi suksese në punën e saj. Pika tjetër ishte:

Shqyrtimi dhe miratimi i raportit gjashtëmuor të punës së Kryetarit e Komunës, Kryetari. z Dalibor Jevtic në pjesën hyrëse të prezantimit të tij, tha se komuna përballlet me sfida të shumta, duke iu referuar disa procedurave që kanë ndikuar në punën e organit administrativ dhe ekzekutiv dhe se veprimet e njësisë speciale të policisë kanë pasur ndikim në komunë dhe gjithashtu edhe të qytetarë dhe pikërisht për këtë ka iniciuar takime të caktuara ku ka kërkuar që disa çështje të trajtohen ndryshe. Më tej ai tha se në ato veprime komuna ka mbetur pa zyrtarë të caktuar dhe se kjo ka shkaktuar edhe vështirësi të caktuara në punën e komunës. Veçanërisht shqetësues është aksioni i ndodhur më 7 korrik, në ditën e festes së fshatit në Shtërpce, kishe për shkak të kamerave të përdorura për spiunazh, gjë që natyrisht nuk është e vërtetë sepse ne kemi dokumentuar se ato kamera janë instaluar legalisht. Ai më tej tha se qytetarët kanë protestuar dhe se ky është qëndrimi i shumicës dërrmuese të qytetarëve të kësaj komune, çfarë mendojnë për të gjitha këto ngjarje, por se ende nuk kemi asnjë përgjigje nga ata që duhet të dëgjojnë dhe ndjejnë, prandaj nuk duan ta pranojnë faktin se këtu qytetarët duan të jetojnë në mënyrë paqësore dhe dinjitoze dhe në veçanti theksoi se qytetarët asnjëherë nuk kanë bërë rezistencë dhe për këtë arsye nuk ka pasur nevojë për një ndërhyrje të tillë. Duke u nisur nga protestat, ai përmendi problemin dhe protestën që ishte në Sevcë, për shkak të ndërtimeve pa leje dhe se ka reaguar edhe komuna dhe se institucionalisht është bërë gjithçka që mund të bëhej, peticioni u miratua, Komiteti për Siguri gjithashtu bëri konkluzione të qarta për këtë çështje, ku

është vërtetuar se komuna është në anën e qytetarëve dhe do të jetë gjithmonë. Ai po ashtu theksoi se ka individë që janë në anën e atyre që e shkelin ligjin dhe veprojnë kundër qëndrimit të udhëheqëses komunale, si dhe kundër qytetarëve, por gjithashtu tha se edhe ata do të trajtohen në mënyrë adekuate në kuadër të procedurave ligjore. Të njëjtën gjë e ka përmendur edhe për organin e përkohshëm, duke theksuar se 60 punëtorët që punojnë atje nuk mund ta bëjnë më këtë punë dhe se nga ana tjetër qytetarët nuk mund t'i marrin më shërbimet që kanë marrë dhe se kjo është një temë që duhet të zgjidhet me një dialog në relacion BG - PR, por dikush ka vendosur ta zgjidhte në një mënyrë tjetër me vendime të njëanshme, dhe kjo është shqetësuese, siç është edhe fakti që është nisur një hetim ndaj 99 personave, kryesisht punonjës të këtij institucionit, dhe ai theksoi se qytetarët e thjeshtë nuk duhet të jenë viktimë të proceseve politike. Ai shtoi se një numër i madh i qytetarëve po aplikojnë për bisedë dhe se tashmë një numër të konsiderueshëm i qytetarëve ka qenë në bisedë dhe se do të përpiqet të komunikojë rregullisht me qytetarët të cilët i tregojnë problemet e tyre personale, ku në rendin e parë është papunësia, zgjidhja e çështjeve të banimit, si dhe ndihmat e ndryshme financiare, si dhe çështja e subvencioneve, etj. Ai tha se qëllimi nuk është vetëm të bisedohet, por edhe të zgjidhen këto probleme dhe se qendra e skijimit në Brezovicë është një nga opsionet, kur është fjala për zgjidhjen e papunësisë. Ai theksoi se është nisur një iniciativë që qendra e skijimit të jetë në pronësi të komunës dhe të punohet në at drejtim, e gjitha me qëllim të mbrojtjes së punëtorëve dhe se gjithçka që do të bëhet do të jetë në koordinim të plotë me punëtorët e Qendrës së Skijimit, për të grumbulluar të hyrat dhe se qëllimi është edhe nisja e një iniciative në formë të Partneritetit Publiko-Privat për të siguruar investime të caktuara dhe në këtë mënyrë të sigurohen vende të reja të punës. Ai po ashtu përmendi se sa i përket papunësisë, si në seancën e kaluar, në pyetja është përfaqësuesi ligjor i komunës i cili është shkarkuar për shkak se nuk ka pasur diplomë të nënshtruar dhe se ky është shembull klasik i diskriminimit, ku ai iu është drejtuar me shkrim. OJQ-së si dhe institucioneve të tjera dhe se ky është një shembull klasik i proceseve të tajerëve politike, sepse ai ka paraqitur kërkesën për nostrifikim, ku ka marrë përgjigje se Ministria e Arsimit aktualisht nuk kryen nostrifikimin e diplomave për ata që e kanë marrë atë në Serbinë qendrore, që është gjithashtu në kundërshtim me kushtetutën e Kosovës.

Më pas ai foli për raportin e institucioneve qendrore ndaj vetëqeverisjes lokale për të përmirësuar kushtet e qytetarëve, por ato nuk janë në anën e qytetarëve dhe nuk i dëgjojnë problemet tona sepse nuk ka decentralizim dhe theksoi se kjo Qeveri nuk di dhe nuk do që të ndihmon dhe se të njëjtat probleme kanë edhe komunat tjera.

Ai vazhdoi duke thënë se është nisur një iniciativë për rregullimin e hapësirave publike që pjesa më e ngushtë e komunës sonë të mirëmbahet rregullisht, që të mos ketë mbeturina në rrugë dhe që kur do të kemi licencë për ndërmarrje komunale do të shtrihet në një pjesë më të gjerë të komunës tonë. Ai vazhdoi me problemin që kemi në qendrën e skijimit, ku një institucion tjetër mbledh të hyrat për hyrjen në qendrën e skijimit, dhe komuna më vonë paguan për heqjen e mbeturinave, sepse aty është krijuar një deponi, por të tjerëve nuk u intereson dhe se është e rëndësishme për ata, që ata të paguajnë vetëm hyrjen, dhe të rrisin buxhetin e tyre.

Ai u ndal edhe në temën e hidrocentraleve, duke thënë se është vërtetuar se komuna e Shtërpçës nuk ka asnjë përgjegjësi për licencimin e hidrocentraleve, gjë që u vërtetua pa dyshim nga raporti, duke theksuar se e vërteta gjithmonë e gjen rrugën e saj.

Ai po ashtu theksoi se do të realizohen disa projekte nga të hyrat vetanake, siç është përmirësimi i rrugëve dhe se do të ndërtohet një objekt ndihmës pranë kishës së Shën Gjonit në Shtërpce, projekt për përmirësimin e varrezave, ndërtimin e një objekti ndihmës dhe trotuari në fshatin Firajë dhe restaurimi i shkallëve të Shtëpisë së Kulturës, do të ndërtohet muri mbajtës për varrezat në Vërbeshicë, si dhe rregullimi i rrugës që çon të ndërtesat e banimit në Brezovicë, rregullimi i parkut dhe parkingut pranë Kishës së “Shën Jovan” në Shtërpce, rregullimi i rrugës dhe kanalizimit nga moteli “Lovac” deri te kopshti i fëmijëve. Ai theksoi se ka ende shumë objekte në të cilat po punohet dhe se prioritetet do të përcaktohen me përfaqësuesit e fshatit. Ai po ashtu ka theksuar përfshirjen e të rinjve në ngjarje të caktuara, se rinia, kultura dhe sporti kanë mbështetje institucionale nga komuna jonë.

Ai gjithashtu theksoi faktin se është mirë që njerëz të njohur po e vizitojnë komunën tonë dhe ta promovojnë atë në mënyrë, duke folur pozitivisht për Zhupen e Sirinjës si dhe për ne që jetojmë këtu, për mikpritjen tonë, e cila është gjithashtu e njohur dhe që ajo është gjithashtu një nga mënyrat për të tërhequr sa më shumë mysafirë si destinacion turistik.

Duke folur për ekonominë, ai tha se në këtë vit çmimi i mjedrës është i mirë dhe se qytetarët tanë pritët të kenë të hyrat më të mira dhe në këtë mënyrë të përmirësojnë gjendjen e tyre ekonomike dhe se ky është një segment në të cilin duhet të investohet dhe që kushdo që dëshiron të punon mund të jetojë nga puna e tij.

Në fund të prezantimit, ai tha se sa i përket financave, dalëngadalë po vendoset një qëndrim i brendshëm ndaj kësaj çështjeje, se ka kursime të caktuara në kategori të caktuara për t'u ardhur në ndihmë qytetarëve tanë. Ai përfundoi se komuna ka punuar në mënyrë cilësore gjatë 6 muajve të fundit dhe se natyrisht ka shumë hapësirë për përmirësimin e punës së komunës dhe se në të ardhmen do të punojmë të gjithë së bashku për këtë.

Për fjalë është lajmeruar **Z. Shpejtim Arifi**, i cili me atë rast tha, se nuk pajtohet me hyrjen e këtij raporti, ku shihet qartë një tendencë që të jepet një konotacion politik dhe se kryetari duhet të kuptojë se pushteti është i ndarë dhe se puna e policisë dhe prokurorisë nuk duhet të kontestohet dhe se nuk ka pasur asnjë reagim nga qytetarët, sepse edhe ata e kuptojnë se këto veprime nuk janë të drejtuara ndaj askujt individualisht dhe se ato kryhen në përputhje me ligjin dhe rendin kushtetues së Republikës së Kosovës. Ai tha se organet ilegale janë të paligjshme dhe se kryetari duhet të punojë në përputhje me ligjin dhe të mos i japë kësaj prapavijë politike.

Kryetari i komunës u përgjigj duke thënë se është dakord me z. Arifi në pjesën ku veprimet e institucioneve të caktuara nuk duhet të jenë politike dhe ne kemi pikërisht atë problem ndaj të cilit nuk duhet të mbyllim sytë. Ai tha se e kupton që po shpreh qëndrimin e tij politik të partisë së cilës i përket, por heqja e fakteve në raportin e kryetarit do të ishte injorim i realitetit në të cilin jetojmë dhe se gjithçka që ai ka cekur ishte vetëm një pjesë e vogël e asaj që ai ishte në gjendje t'ua përcjellë personalisht përfaqësuesve të institucioneve qendrore si dhe anëtarëve të komuniteteve ndërkombëtare dhe theksoi se përfaqësuesit e komuniteteve ndërkombëtare janë

pajtuar me të se ka problem me mënyrën e funksionimit të institucioneve të caktuara në territorin e komunës. Ai i tha se nuk mund të thotë se nuk ka pasur asnjë reagim nga qytetarët sepse ka pasur një reagim në formë protestës si dhe qytetarët që kanë ardhur tek ai dhe kanë shprehur shqetësimet e tyre dhe se është obligimi i tij që të jetë në anën e qytetarëve.

Më tej, **z. Jevtic** tha se ai e dëgjoi me vëmendje intervistën e tij në ditën e aksionit të fundit, duke theksuar se mënyra se si ai foli ishte e gabuar, sepse ka thënë disa fakte të pasakta. Ka thënë të njëjtën gjë **z. Arifi**, sepse priste që së pari të thoshte diçka këtu, duke pasur parasysh se këtu nuk ka thënë pothuajse asgjë, duke theksuar se është këtu dhe se është i gatshëm për çdo lloj bisede demokratike për të zgjidhur çdo problem së bashku. Kryetari i komunës tha **z. Arifi** se ajo që ka thënë për kamerat nuk është e saktë, sepse e kemi vërtetuar gjendjen e vërtetë faktike dhe se ajo që ka ndodhur më 7 korrik është një shfaqje për publikun. Ai theksoi se komuna është transparente dhe se ndoshta për atë janë institucione ilegale, por jo për të dhe se nuk do të jenë kurrë. Ato institucione nuk kanë ofruar shërbime vetëm për serbët, por edhe për një pjesë të caktuar të shqiptarëve dhe ju i quani të paligjshme, tha kryetari. Ai ishte i mendimit se **z. Arifi** duhet të votojë për këtë raport sepse paraqet një situatë relevante dhe reale të gjithë asaj që ka ndodhur në gjashtë muajt e kaluar.

Z. Arifi u lajmëruar për replik duke thënë se e kupton prirjen e kryetarit të komunës për të kritikuar opozitën, por kjo nuk është reale, duke thënë se ai është zgjedhur nga qytetarët dhe se e fokuson punën e tij në zgjidhjen e problemeve të të gjithë qytetarëve, pa dallim kombësie dhe nacionalitetit dhe fejesë. Ai tha edhe për pjesën ku ka dhënë një intervistë për një televizion, duke thënë se është gëzuar që kryetari e ka dëgjuar deklaratën e tij dhe ka thënë të vërtetën dhe se nuk ka ditur për kamerat dhe ka rezultuar se ato ekzistojnë në shkolla si dhe të organet ilegale të komunës, dhe po ashtu tha se kishte dijeni për kamerat e vendosura në qendër të Shtërpcës dhe se e komentoi të gjithë situatën ashtu siç mendonte se duhej të ishte dhe se ishte realist për këtë.

Z. Jevtic u përgjigj duke thënë se ai është kryetari i qytetarëve të të gjitha nacionaliteteve dhe se po përpiqet t'i zgjidh problemet e qytetarëve nga të dyja komunitetet dhe përsëriti se nuk ka institucione që mund të quhen të paligjshme sepse jeta e qytetarëve varet nga ato dhe ata duhet të lejohen të kenë një jetë normale dhe të qetë. Dhe ai tha se asnjë nga kamerat nuk u hoqën atë ditë përveç kamerave të bankës Finca, kështu që kryetari i komunës pyeti se pse nuk u hoqën ato kamera spiune dhe ai tha se nuk ishin të tilla sepse nuk është e vërtetë. Ato veprime të policisë kanë për qëllim frikësimin e njerëzve, disa familje janë shpërngulur pas atyre ngjarjeve dhe ne nuk do të heshtim sepse në këtë mënyrë do të miratojmë gjithçka që po ndodh, theksoi kryetari. Ai tha se nuk është problem për të të flasë këtu dhe të prezantojë të vërtetën dhe të mbështesë luftën kundër korrupsionit, por jo atë që ka prapavi politike të njëjtin sme ato veprimet e policisë dhe gjithashtu theksoi se nuk ka asnjë problem se ai flet pozitivisht për qeverinë këtu nëse bën diçka të tillë.

Z. Arifi sërish është lajmëruar për replik, duke thënë se kryetari ishte i brengosur që nuk kishte folur deri më tani dhe se nuk është puna e tij të flasë se çfarë do të bëjë policia dhe prokuroria dhe se ato që ai tha në televizion janë vetëm gjendja reale dhe mënyrën se si punohet në komunën tonë.

Z. Jevtic tha z. Arifit se e di se çfarë ka thënë në televizion kur ka pasur intervistë dhe prandaj e di se për çfarë po flet tani dhe se është evidente se ka një problem dhe se kushdo që konstaton disa gjëra paraprakisht është gjithashtu duke kryer vepër penale dhe se askush nga ne nuk mund të thotë se dikush është fajtor për diçka sepse, askush nuk është fajtor derisa të vërtetohet në gjykatë, dhe z. Arifi ka shprehur qëndrimin e tij se kush është fajtor dhe se është shkelje e disa të drejtave të njerëzore. Më tej, kryetari tha se nëse dikush nga pushteti del dhe dënon dikë paraprakisht, kjo është presion mbi gjykatën dhe gjyqësorin dhe askush nuk ka të drejtë ta bëjë këtë dhe se duhet të kemi kujdes në atë që deklarojmë.

Z. Valjmir Ahmeti. mori fjalën e ku e pyeti kryetarin se sa persona nga komuniteti shqiptar ka pranuar për intervistë, pasi në raport thuhet se ka pasur mbi 400 persona që janë lajmëruar për intervistë? Ai ftoi edhe z. Jevticin për të vizituar vendet ku jetojnë qytetarë nga komuniteti shqiptar dhe të bisedon me ta, dhe të viziton qendrën e mjekësisë familjare, ai u ankua për faktin se nuk ka terrene sportive, kënde lojërash, infrastrukturë, si dhe rrugë janë të pakalueshme për shkak të vërshimeve. Ai theksoi se është mirë që Drejtoria për Shërbime Publike reagon shpejt kur ka probleme. Ai vazhdoi duke thënë se shqetësues është edhe fakti që komuna nuk e ka mbështetjen e Qeverisë dhe se e ka për obligim që të mbështesë projektet që vijnë nga komuna jonë dhe se pushteti ekzekutiv duhet të gjejë mënyrën për t'i realizuar këto projekte. Ai tregoi se është iniciativa e mirë e nisur nga kryetari i komunës ka të bëjë me hapjen e spitalit dhe se nga kjo do të përfitojnë qytetarët e komunitetit serb dhe shqiptar. Dhe në fund iu drejtua drejtorit të shëndetësisë dhe i tha se ka mungesë të madhe barnash, se sa ai ishte drejtor i shëndetësisë ka pasur mbështetjen e pushtetit ekzekutiv, drejtoreve ashtu edhe ish-kryetari i komunës z. Nikolic dhe se në atë kohë ambulante janë furnizuar rregullisht me barna dhe ishte i mendimit se ky problem duhet të zgjidhet sa më shpejt. **Kryetari i komunës**, duke iu përgjigjur pyetjes së z. Ahmeti tha se për të gjithë qytetarët janë të barabartë, qofshin ata nga një komunitet serb apo nga tjetri dhe se nëse interesohet për informacione të detajuara, mund t'i marrë më vonë, dhe se pafërsisht 10 qytetarë të nacionalitetit shqiptar kanë ardhur tek ai për bisedë dhe se disa nga kërkesat e tyre janë realizuar. Ai më tej tha se shpreson që do të zgjidhet nënkryetar për komunitete dhe se bashku do të mund të krijojnë një plan për problemet e ndryshme që kanë të bëjnë me komunitetin shqiptar, ndërsa sa i përket projekteve tha se po punohet për ata dhe se po dërgohen në Qeveri që të realizohen në kapacitetin në të cilin është e mundur, sepse buxheti i komunës jonë është shumë i vegjël. Sa i përket spitalit, ai theksoi se qëllimi është që ai të hapet dhe të fillojë me punë dhe të punohet në të dhe se shpreson që në një të ardhme të afërt spitali do të funksionojë normal. Qytetarët e komunës sonë e meritojnë kujdesin sekondar shëndetësor dhe synimi është që aji të ofrojë shërbime sa më të larta, që bashkëqytetarët tanë të mos shkojnë në spitalet tjera në mbarë Kosovën, tha kryetari.

Më pas z. **Slavisa Vasiljevic**, tha se ende në përshtypjen e asaj që ka ndodhur në mëngjesi i sotëm në shtëpinë e tij dhe se i vjen keq që kryetari i komunës nuk ka dashur të komentojë atë që ka ndodhur me një fjali të vetme dhe se ka folur për veprimet e policia dhe se kjo flet shumë sepse ai shikon gjithçka në mënyrë selektive. Ai vazhdoi duke folur për raportin e kryetarit dhe se ka vërejtur se në vetë raport ka shumë mesazhe politike dhe se ka pak praktike në punë ashtu siç duhet të duket puna e kryetarit. Ai përmendi një shembull ku dërgohen mesazhe politike, që ka të bëjë me ndërtimet pa leje në Sevacë, ku në atë pjesë të raportit tha qartë se po veprojnë

individë që i përkasin një grupi të caktuar politik dhe që duan të destabilizojnë situatën, ku ai më tej tha se duhet ta informojë kryetarin se ai si përfaqësues i një grupi politik dënon qartë gjithçka që ka ndodhur në Sevacë dhe se është arritur unitet absolut për atë çështje dhe ka theksuar se është një nga nënshkruesit e peticionit kundër ndërtim pa leje. Më pas ai theksoi se nuk është mirë që kryetari të dërgojë një mesazh të tillë politik, se gjithçka është në dorën e ekzekutivit dhe se është ai që mund të ndalojë ndërtimet. Ai tha gjithashtu se kur flitet për individë, ka thënë z. Jevticit është dashur të thotë se ka pasur individë që kanë ndihmuar një zotëri të caktuar që ka blerë atë pronë, se duhet të tregojë emrin dhe mbiemrin e personit që e ka ndihmuar për të shitur pronën, ai person ka ardhur me makina zyrtare në Sevacë dhe ka theksuar se kryetari i komunës ka qenë në dijeni dhe se ka mundur ta përfshijë në raport sepse nga raporti shihet qartë se kryetari dëshiron ta politizojë rastin. Ai është i mendimit se nuk duhet që të politizohet dhe është munduar për një gjë të tillë dhe dihet se ka mbështetur kryetarin dhe banorët e Sevacës dhe po ashtu ka thënë se ka organe ekzekutive ka Drejtoria e Urbanizmit, ka një ligj për ndërtim që rregullon se si një person i caktuar duhet të ndërtojë në një territor të caktuar. Ai ka komentuar edhe atë që ka thënë kryetari i komunës se ka pranuar mbi 400 qytetarë dhe meqenëse nuk i intereson numri e qytetarëve, ka pyetur kryetarin se a ka ndihmuar, një numër të caktuar të qytetarëve dhe në çfarë kuptimi i ka ndihmuar? Ai vazhdoi duke thënë se kryetari i komunës ka pranuar Stalet Staletovicin nga Gotovushë, i cili ka investuar mbi 150 mijë euro në ndërtimin e një pompe, ku qeverisja e kaluar ia ka anuluar vendimin dhe është interesuar nëse z. Jevtic dëshiron ta ndihmojë dhe kontribuojë në çfarëdo mënyre që ai të bëjë punën që ka nisur? Më pas ai tha se kryetari ka pasur bisedime me punëtorët e kulturës, sportistit dhe klubeve dhe ka thënë se nuk është organizuar asnjë ngjarje kulturore për periudhën e raportimit të kryetarit dhe z. Vasiljevic ishte i mendimit se kjo flet shumë se sa e rëndësishme ka qenë tema për kryetarin e komunës dhe se buxheti i miratuar për vitin 2022, në asnjë segment nuk parasheh mbështetjen e aktiviteteve kulturore në komunën e Shtërpçës. Të njëjtën gjë ai tha edhe për ngjarjet sportive, duke pasur parasysh se kryetari i komunës ka biseduar me sportistët dhe mendon se ky vit ka qenë i humbur për sportistët tanë dhe se sportistët nuk kanë garuar në asnjë rang dhe ka konsideruar se ky vit ishte një dështim i plotë për sportistët. Ai vazhdoi duke folur për punësimin, ku tha se përveç disa punësimeve politike, nuk ka pasur të tjera dhe se nuk e ka parë që kryetari i komunës ka punuar në të dhe në këtë kontekst i tha kryetarit se i kishte dërguar një mesazh të qartë për qytetarët se ka qenë në bashkëpunim me zyrën për K dhe M dhe ka siguruar mjete për të gjithë personat e papunë në komunën e Shtërpçës dhe ka qenë i mendimit se me këtë ka keqpërdorur K dhe M.

Fjalën ka marrë z. Jevtic për t'iu përgjigjur z. Vasiljevicit, duke thënë se ai nuk paraqitet si përfaqësues i një partie të caktuar politike në gjykatë, polici dhe prokurori, por këtë e bëjnë vëllai i tij dhe të afërmit e tij, të cilët janë në mesin e atyre që tentuan ndërtimin e paligjshëm në Sevacë, dhe se z. Vasiljevic nuk e ka problem me të, por me të afërmit e tij dhe duhet të bisedojë me ta dhe të shohë pse ata paraqiten si përfaqësues të partive të caktuara politike.

Kryetari i Kuvendit më pas lexoi pjesën nga Rregullorja për punën e Kuvendit, ku thuhet se asnjë person nuk mund ta ndërpresë seancën apo të debatojë me ndonjë person tjetër që mban fjalim dhe e gjithë kjo është z. Grbic ka cekur për arsye se z. Vasiljevic e ka ndërpreu z. Jevticin.

Kryetari i komunës vazhdoi duke thënë se gjithçka që ka shkruar në raport ekziston për atë gjendje faktike dhe tha se nga raporti që ka lexuar e di se kush dhe si paraqitet dhe se kur dikush paraqitet si aktivist, qoftë edhe kryetar i partisë, që ju i përkisni, atëherë është fakt që po këta njerëz mbështesin ata që sjellin trazira në shoqërinë tonë. Ai vazhdoi duke thënë se nëse ekziston një parti e caktuar politike, nuk ka parë që dikush të mbrohet publikisht dhe tha se ata nuk janë më anëtarë dhe se nuk veprojnë politikisht dhe se çdo gjë që bëhet, bëhet për arsyen. se komuna qëndroi pranë qytetarëve të saj si dhe vetë kryetarit. I njëjti ka thënë z. Vasiljevic se e dinte që lajmëronte dhjetë herë në ditë për gjëra të ndryshme, kritikonte njerëz të ndryshëm për këtë çështje dhe se kur e pa se ishte vëllai i tij, nuk shkroi asnjë fjalë më shumë për këtë dhe se me atë heshtje ai po e përkrahte atë veprim. Sa i përket punësimit politik, ai tha se vëllai i tij ishte i punësuar politikisht, sepse njerëzit ishin pranuar rregullisht në konkurs dhe pas kësaj, në bazë të këtyre individëve nga partia politike e z. Vasiljevic, ata persona janë larguar dhe më pas janë pranuar anëtarë të partisë së tij, dhe ata të cilët humbën punën kanë shkruar te kryetari i komunës për ta pyetur se pse kanë humbë punën. Më tej ai tha se z. Vasiljevic tenton vetëm të kritikojë qeverinë aktuale dhe se nëse ka diçka pozitive tek ai, është se ai beson se kryetari dhe kolegët e tij mund t'i zgjidhin problemet shpejt, se ai ka pritshmëri të mëdha. Kryetari i komunës ju ka drejtuar z. Vasiljevic dhe ka thënë që ai nuk e dinte se kishte ngjarje kulturore dhe sportive, se nuk ishte i informuar mirë për këtë dhe se nuk ishte detyra e tij ta informonte për këtë. Më tej ai foli për faktin se z. Vasiljevic ka dhënë një shembull të një qytetari që nuk ka lidhje me komunën dhe që me atë nuk është njoftuar, por është këtu për të folur e për të thënë, sepse bëhet fjalë për një proces që është në gjykatë dhe për të cilin gjykata duhet me së parë me vendos si do të veprohet për ta zgjidhur dhe jo kryetari i komunës. Ai deklaroi se problemi është se ai kritikon dikë që e konsideron kundërshtar politik, pavarësisht nëse është e vërtetë apo jo dhe se në këtë mënyrë gjërat politizohen dhe se kritika duhet të mbështetet me fakte. Ai po ashtu tha se ka kritikuar edhe një përfaqësues politik të serbëve, një profesor të nderuar, nga Kroacia që ishte këtu dhe se për këtë arsye po kritikonte faktin se ne duam të lidhemi me bashkatdhetarët tanë në rajon, se nuk gjeti përgjigje kush mund ta justifikonte një gjë të tillë dhe se nuk tha asnjë fjalë ditën kur u vranë 14 korrësit, por prandaj ka gjetur kohë që të kritikonte. Më pas ai tha se e gjithë kjo flet shumë për z. Vasiljevicin dhe se e gjithë kjo për faktin se ai është verbuar nga urrejtja dhe për këtë arsye po sulmon pushtetin komunal pa fakte dhe kështu e dëmton veten. Pastaj z. Vasiljevic e ndërpreu z. Jevticin, z. Jevtiqi i tha se është i pakulturuar dhe se nuk është në treg por në institucion dhe se duhet të jetë parlamentar dhe ta dëgjojë. Ai vazhdoi duke i thënë se kishte një shans me atë që po ndodhte në Sevac, të tregojë sinqerisht se është në anën e drejtësisë dhe së vërtetës dhe se këtë nuk e ka bërë sepse nuk ka kritikuar ata që janë anëtarë të partisë së tij politike dhe që i japin vetes të drejtën t'i thonë pikërisht këtij personi se janë me ta, se do t'i japin të gjithë mbështetjen dhe se ai do t'ia dalë me qëllimin e tij. E gjithë kjo tregon qëndrimin ndaj kësaj çështjeje, tha kryetari i komunës z. Vasiljevic, si dhe frikën e pranishme tek ai për të përballuar siç duhet sfidën që kishte në atë moment. Në fund, kryetari i komunës tha se mendon se ajo që z. Vasiljevic tha në fillim duhet të diskutohet nën pikën e ndryshme, sepse ai i përmbahet rendit të ditës.

Pas kësaj, z. Vasiljevic është lajmëruar për replik duke thënë se këtu ka pasur keqpërdorimi i Kuvendit dhe të gjithave, sepse këshilltarëve u jepet 2 minuta dhe kryetari mund të flasë pa kufizim e kohës, për ne këshilltarët, i cili njëkohësisht tregojmë gënjeshtra dhe mendime, ai

mendoj se duhet futur njëfarë barazie në këtë çështje dhe se kryetari mund të jepen gjithashtu 2 minuta për të folur. Ai vazhdoi duke thënë se lidhur me këtë temë dhe rastin në Sevcës, ka theksuar se i përket grupit politik Iniciativa e Qytetareve dhe është formuar gjatë zgjedhjeve dhe nuk ka kryetar partie dhe ka theksuar se nuk mund të sanksionojë në asnjë mënyrë dhe as nuk ka mekanizma për të ndikuar te njerëzit që e mbështetën në zgjedhje. Partia politike që z. Vasiljevic e përfaqëson nuk e ka kryetarin e partisë, ajo ka pasur një person kontaktues që ka komunikuar me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe nuk ka organe si partia politike e kryetarit, nuk ka poste të paguara në partinë GI, siç është kryetari i komunës së Shtërpçës. theksoi z. Vasiljevic. Më pas ai tha se ishte shumë e vrazhdë që ai të përmendte familjarët e tij dhe i tha se familjarët e tij ishin deri vonë shokët e tij politikë që e sollën në disa poste dhe që e mbështesnin dhe shkonin në takime të përbashkëta, në festat të ndryshme dhe në marrëdhëniet e tyre nuk ishin vetëm politikë por edhe miqësorë dhe tha z. Vasiljevic se kryetari nuk mund ta kritikon në atë mënyrë sepse është e vrazhdë. Ai më tutje theksoi se sa i përket ndërtimeve pa leje në Sevcë, se kryetari i komunës duhej të thoshte se njeriu që i shkaktoi më shumë dëme Sevcës ishte këshilltari i tij nga Ministria për Komunitete dhe Kthim, i cili personalisht ka ndihmuar B.M. i cili po kryen punë ilegalisht dhe tha se gjithmonë do t'i dënojë të gjithë ata persona që ndihmojnë në çfarëdo mënyre në ato dukuri negative në tërë Zhupen e Sirinicës dhe jo vetëm në Sevacë. Ai ka theksuar se ky është qëndrimi i tij, të cilin e ka shprehur qartë përmes peticionit dhe po ashtu ka theksuar se kryetari i ka duartrokatur para komisarit dhe se e di shumë mirë. z. Vasiljevic tha gjithashtu se është i mërzitur nga e gjithë situata që po politizohet dhe se ai nuk e bën këtë, është një problem i përgjithshëm për të cilin është i gatshëm të bashkëpunojë jo vetëm me kryetarin e komunës por edhe me këshilltarët e komunitetit shqiptar me qellim për të arritur drejtësinë si është vendosur ai në gjithë këtë situatë. Dhe ajo që po bën kryetari është politizim i plotë, përfundoi z. Vasiljevic.

Z. Jevtic mori fjalën për t'iu përgjigjur z. Vasiljevicit dhe fillimisht i tha se do të duhej ta shihte atë me të për pretendimet që ai bëri për ish-këshilltarin e tij dhe se kryetari nuk kishte asnjë lidhje me të. Ai më pas tha se pavarësisht se z. Vasiljevic u ndihmua aq shumë sa që ata treguan fytyrën e tyre të vërtetë dhe cilësitë e tyre që posedojnë si njerëz. E kush ka qenë anëtar i cilës parti dhe kush ka vepruar politikisht, tha se z. Vasiljevic ishte gjithmonë në anën e kundërt që nga fillimi i ekzistencës së tij politike.

Për shkak të ndërhyrjes së vazhdueshme në fjalën z. Jevticit nga z. Vasiljevic, kryetari i Kuvendit u detyrua të bëjë një pushim të shkurtër.

Seanca vazhdon pas pushimit

Z. Grbic. Pas pushimit, e vendosi në votim raportin e punës së kryetarit dhe ka konstatuar se ai u miratua me 9 vota pro, 3 kundër 2 abstenime. Pika tjetër ishte:

Prezantimi i raportit financiar gjashtëmujor për periudhën janar - qershor 2022 dhe raporti për nivelin e arkëtimit të të hyrave vetanake, ku z. Jevtic ka marr fjalën dhe tha se një nga qëllimet është rritja e të hyrave vetanake, sepse ne varemi shumë prej tyre dhe se ka hapësirë për rritjen e PSV-së. Ai po ashtu tha se në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve do të ketë shpenzimet më të madha për faktin se hartimi i projekteve të detajuara tani paguhet nga kjo

kategori, ndërsa më herët është paguar nga investimet kapitale. Ai theksoi se kemi kursime prej 80% në dreka zyrtare dhe se po shihet se në përputhje me ligjin që paratë që kemi në dispozicion shkojnë për qytetarët tanë më të rrezikuar. Ai tha gjithashtu se disa projekte duhet të rishikohen për shkak të rritjes së çmimeve në treg dhe se këto janë rritje prej 60-70%. Kemi probleme në realizimin e disa projekteve, procedurave sepse ka vonesa në Ministrinë e Financave për shkak të atyre procedurave, sa i përket regjistrimit të personave fizikë të cilëve duhet t'u paguajmë ndihmë, por kjo nuk varet nga ne, por për këtë duhet të jenë të vetëdijshëm edhe qytetarët, përfundoi kryetari i komunës.

Z. Vasiljević pastaj mori fjalën për të komentuar raportin, duke thënë se ai përmban një paraqitje klasike tabelorë, ku ne nuk kemi informacion se si janë shpenzuar mjete e caktuara në periudhën raportuese. Sa i përket kursimeve, ai tha se nuk kanë kuptim sepse mjetet nga një linjë buxhetore nuk mund të shpenzohen në një linjë tjetër buxhetore dhe se këto mjete më vonë shkojnë në suficit dhe se për të është një lloj marketingu, që gjoja të kursehet dhe se paratë nga ana tjetër nuk mund të përdoren, ku më tej theksoi se vetëm 10% e mjeteve mund të kalojnë nga një linjë buxhetore në tjetrën dhe se ky kursim nuk ka asnjë kuptim. Ai tha se buxheti është bërë keq, se disa paragrafe të buxhetit janë rregulluar në atë mënyrë që dikush ka planifikuar 34 mijë euro dhe se tani nëse e bëjmë atë lloj kursimi, ato para do të shkojnë dëm dhe e gjithë kjo është marketing dhe mashtrim, për atë.

Kryetari i komunës u përgjigj duke thënë se kjo nuk mund të jetë marketing apo mashtrim, sepse ka një mënyrë brenda procedurave ligjore ku mund të ndihmojmë familje të caktuara në mënyra të ndryshme nga kjo kategori, pra ka një mënyrë për t'i shpenzuar ato para. Më tej ai tha se diçka tjetër përveç kësaj mund të quhet trik marketingu dhe se nuk do t'i kuptojë ata që kritikojnë se përfaqësuesit e komunës shpenzojnë shumë para për reprezentacionet dhe pastaj kur kemi kursime, thotë se është një trik marketingu dhe theksoi se nuk është mënyra siç duhet me thënë dhe se gjëra të tilla duhen me u përshëndetur dhe ata që nuk duan gjithmonë gjejnë justifikime. Ai po ashtu tha se edhe nëse duhet ndonjë pare të shkon në suficit, le të shkojë sepse sigurisht nuk do të ketë dreka të panevojshme, sepse së pari udhëheqja komunale nuk ka kohë për këtë dhe nuk ka nevojë për këtë.

Z. Vasiljevic është lajmëruar për replik, ku tha se sa i përket të buxhetit nuk e ka shpikur ai, por e ka bërë përmbajtja e fundit e Kuvendit, sepse kështu ka menduar dhe e ka miratuar buxhetin ashtu siç është dhe ai e konsideroi se ishte e gabuar dhe për këtë arsye ai beson se ky lloj kursimi nuk ka kuptim dhe përsëri ishte i mendimit se ishte një lloj mashtrimi.

Z. Grbic tha G. Vasiljevicit se sa i përket buxhetit, komuna mund të ketë ndikim vetëm kur bëhet fjalë për investime kapitale dhe se Kuvendi së bashku me qytetarët i caktojnë ato projekte që varësisht nga mjetet që i kemi do të ndahen me prioritet projektet, dhe kur është fjala për të gjitha kategoritë e tjera ati i përcakton Ministria.

Kryetari i komunës më pas tha se ka një letër qarkore e buxhetit e cila është dhe buxheti është përcaktuar nga institucionet qendrore në bazë të kësaj. Ai më tej tha se duhet të jemi mirë të informuar para se të themi diçka, sepse nuk ka kuptim të kritikosh diçka vetëm pse je opozitë,

sepse kritika duhet të drejtohet drejt diçkaje, që duhet bërë më mirë dhe se ai e ka kuptuar atë kritikë në kuptimin që të gjithë duhet të shkojnë në dreka që paratë të mos shkojnë në suficit.

Drejtori i Administratës, z. Havzi Ahmeti mori fjalën dhe tha se buxheti i komunës është i ndarë nga granti i qeverisë dhe se për këtë bëhet kujdes, sepse vetëm mjetet nga granti i qeverisë shkojnë në suficit dhe se mjetet nga të hyrat vetanake nuk shkojnë në suficit por transferohen në vitin e ardhshëm, dhe theksohet se komuna e Shtërpçës është një nga komunat më të mira sa i përket shpenzimit të buxhetit dhe gjithmonë ka pasur vlerësimin më të lartë për performancë.

Drejtori i Financëve, z. Djorgje Djorgjevic është ndërlidhur në atë që ka thënë drejtori i administratës dhe se ato pretendime janë në raport, se mjetet që kemi marrë nga granti i qeverisë dhe se 90% e mjeteve janë shpenzuar nga granti i qeverisë, ai tha se të hyrat vetanake monitorohet me kujdes dhe në moment kur ka nevojë për shfrytëzimin e tyre do të shfrytëzojnë, ai theksoi se fillimisht shpenzohen mjetet e marra nga granti qeveritar, e më pas të hyrat vetanake, nëse ka nevojë dhe nëse nuk ka nevojë, ato mjete transferohen në vitin e ardhshëm.

Kjo pikë nuk votohet, kështu që kemi kaluar në pikën tjetër të rendit të ditës, e cila ishte:

Rishqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për funksionimin dhe bashkëpunimin e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe vendbanimet urbane, ku fjalën e ka marrë z. Havzi Ahmeti i cili tha se kjo pikë është përsëri në rendin e ditës sepse në Kuvendin e kaluar ka ndodhur një gabim dhe se tani është korrigjuar dhe mund të miratohet si e tillë.

Z. Grbiq më pas e ka qitë në votim këtë pikë dhe ajo u miratua me 13 vota për 1 abstenim. Më pas u kalua në pikën vijuese të rendit të ditës:

Shqyrtimi i Propozim Rregullores për taksat komunale dhe vendimi për vendosjen e kësaj Rregullores në debat publik, ku Kryetari i Kuvendit ka sqarua se kjo Rregullorja nuk votohet, por shkon në debat publik dhe se aty diskutohet dhe bëhen propozime dhe se pas gjithë atyre procedurave duhet të miratohet.

Kryetari i komunës më pas tha se është e rëndësishme që qytetarët të përfshihen në këtë procedurë dhe në fund të miratohet Rregullorja e ndryshuar, e gjitha kjo me qëllim të rritjes së të hyrave vetanake. Qëllimi i tij ishte të motivonte biznesmenët që operojnë në shumë zona rurale dhe të hiqet taksa, dhe për ata që kanë një biznes të mirë, veçanërisht në zonën e vikendiceve, t'i rregullonin taksat në mënyrën e duhur, por që e kanë vërejtje, se është një ligj që thotë se kjo është e pamundur dhe se do të ishte diskriminim, dhe ai ishte i mendimit se është gabim sepse nuk është njësoj të kesh restorant në Gotovushë dhe në zonën e vikendiceve, theksoi z. Jeftic. Ai vazhdoi duke thënë se beson se ne jemi një komunë turistike dhe se 500 mijë euro në total të hyrat vetanake nuk janë diçka që pasqyron, pasqyrën reale të ekonomisë në komunën tonë, në atë sektor real.

Z. Arifi është lameruar për fjalën ku pyeti nëse ka mundësi që këshilltarët të japin propozimet e tyre për hartimin e Rregullores, pas diskutimit publik?

Z. Grbic u përgjigj duke thënë se është duke u thirrur një debat publik dhe në atë debat publik qytetarët do të kenë propozimet e tyre se sa duhet të jenë taksat dhe sigurisht më vonë do të

mund të paraqesim propozime në Kuvend. Propozimi u hodh në votim dhe u miratua unanimit. Pika tjetër ishte:

Raporti i auditimit të performancës për sistemin e licencimit të hidrocentraleve dhe monitorimi i ndikimit të tyre në mjedis dhe ujë

Z. Jevtic ka marr fjalën dhe foli për faktin se komunës së Shtërpçës i është bërë presioni i madh lidhur me çështjen e hidrocentraleve dhe se ajo ka pasur përgjegjësinë më të vogël dhe se Komisioni Parlamentar i Kosovës ka kërkuar një auditimi të jashtëzakonshme i cili është bërë dhe i cili ka vërtetuar se komuna nuk ka shkelur ligjin dhe se nuk ka asnjë përgjegjësi kur bëhet fjalë për hidrocentralet dhe se përgjegjësia bie tek institucionet qendrore dhe se nuk ka asnjë rekomandim komuna e Shtërpçës nga të gjithë 11. Ai po ashtu theksoi se komuna e Shtërpçës nuk ka vepruar në kundërshtim me ligjin për dhënien e licencës për hidrocentrale dhe është konstatuar se hidrocentralet nuk i kanë të gjitha lejet e nevojshme. Ai po ashtu tha se inspektorat e komunës së Shtërpçës i viziton rregullisht dhe raporton me shkrim në Ministrinë për Planifikimi Hapësinor, si dhe kërkohet ndërprerja e funksionimit të hidrocentraleve për shkak se 4 hidrocentrale nuk kanë licencë për të operuar prej gjithë 5, por Inspektorati i Ministrisë, pas të gjitha letrave, nuk ka bërë asgjë për këtë. Më tej ai tha se është në pritje të përgjigjes së organeve përkatëse për të ndërpre funksionimin e hidrocentraleve dhe ka theksuar z. Jevtic se sa i takon atij personalisht mund t'i largojnë menjëherë sepse nuk na kanë sjellë asgjë të mirë. Ai po ashtu ka theksuar se mbledhja e kaluar e Kuvendit ka marrë një vendim me të cilin kërkohet ndërprerja e funksionimit të hidrocentralit, por edhe ky është injoruar, përfundoi kryetari.

Z. Arifi është lajmëruar për të fjalë dhe tha se e dinte mirë problemin e hidrocentraleve dhe se kishte marrë pjesë në protesta kundër ndërtimit të tyre. Ai më tej tha se e ka lexuar këtë raport të auditimit dhe mendon se edhe komuna ka një pjesë të përgjegjësisë sa i përket ndërtimit dhe ka pyetur kryetarin e komunës nëse janë ndërmarrë veprime në këtë drejtim? Ai theksoi se për ndërtimin e një hidrocentrali deri në 10 megavat lëshohet leje mjedisore komunale dhe se komuna është përgjegjëse për dhënien e lejeve ujore dhe se kjo përcaktohet me akt nënligjor për lejen ujore dhe se Mbikëqyrjen e lejes ujore komunale e bëjnë inspektorët e komunës, andaj u interesua se a e kryejnë atë punë dhe a kanë raport me shkrim për këtë?

Kryetari pastaj përsëriti atë që kishte thënë në fjalimin e kaluar, përkatësisht se komuna e Shtërpçës nuk ka shkelur asnjë ligj, por se z. Arifi duhet të lexojë të gjithë ligjin për të parë se si merren lejet. Dhe ai tha gjithashtu se inspektorati, pra komuna nuk mund ta ndalojë funksionimin e hidrocentralit sepse nuk e ka atë autoritet, por se letrat dërgohen rregullisht dhe madje raportet janë dërguar të znj. Fitore Pacolli, e cila është kryetare e atij komisioni në Kuvendin e Kosovës, dhe se ka folur me të dhe se ajo i ka premtuar se do ta shohë se për çfarë bëhet fjalë, por më vonë është ndalur në këtë dhe ka thënë se përgjegjësin e kanë institucione qendror dhe e pyeti veten pse nuk e ndalin sepse nuk ka asnjë pengesë për ta ndalur, duke iu referuar në radhë të parë Ministrisë së Mbrojtjes së Mjedisit.

Z. Arifi është lajmëruar për replik ku tha se kjo çështje është e rregulluar me ligjin për ujërat dhe se ligji është më i fortë se aktet nënligjore. Ai theksoi se ai si banor i kësaj Zhupës dhe si

përfaqësues i qytetarëve, së bashku me kryetarin e komunës dhe institucionet e tjera, kërkon të ndalet degradimi i natyrës dhe që gjithçka të kthehet në normalitet.

Z. Jevtic tha se komuna e Shtërpçës po kërkon ndërprerjen e funksionimit të hidrocentraleve dhe se ai si kryetar i komunës beson se ato janë të dëmshme dhe se qytetarët duhet ta dinë se komuna nuk ka kompetencë ligjore për të ndërprerë funksionimin të hidrocentraleve, dhe ai u bëri thirrje të gjithë atyre që kanë autoritetin ligjor për ta bërë këtë.

Pastaj fjalën e mori **z. Vasiljevic**, i cili tha se përgjegjësinë më të madhe për ndërtimin e mini-hidrocentraleve e ka vetë komuna e Shtërpçës dhe se tani nuk do të kishin auditime dhe raporte nga ministri të caktuara nëse ndërtimi i hidrocentraleve në territorin e komuna e Shtërpçës nuk kishte ndodhur. Njëri nga hidrocentralet është ndërtuar në një zonë të mbrojtur, përkatësisht në parkun kombëtar në malin e Sharrit, tjetri është ndërtuar në vendbanimin në Shtërpçë, ku rrezikohet furnizimi me ujë i popullatës. Më pas ai theksoi se e shqetëson fakti që dikush thotë se komuna e Shtërpçës nuk ka asnjë përgjegjësi lidhur me këtë çështje, sepse KK i Shtërpçës ka marrë një vendim të turpshëm në vitin 2013 që investitori ka të drejtë të shfrytëzojë tokenë e Komuna e Shtërpçës, për 15 vjet pa debat publik. Më pas, në të njëjtin vit, Drejtoria e Urbanizmit ka marrë vendim për ndërtimin e një mini-hidrocentrale dhe mendohej se pa këto dy vendime, investitori nuk do të kishte të drejtë që të paraqiste kërkesa në ministri, për të marrë dokumentacion të tjera të caktuara. Ai ka theksuar se komuna e Shtërpçës ka përgjegjësinë e vetme për ndërtimin e hidrocentraleve dhe ka rezultuar se ato janë krejtësisht të panevojshme për sa i përket prodhimit të energjisë dhe po ashtu ka theksuar se shkatërrimi i natyrës është histori e veçantë. Më tej ai tha se nuk kanë as leje ujore dhe as leje e mjedisore dhe se ka është një dështim i plotë.

Kryetari i komunës tha **z. Vasiljevic** se ka një problem me të sepse çdo gjë bazohet në paushall dhe gjysmë-informacion. Kur bëhet një auditim, tha kryetari, ai e përfshin të gjithë procesin dhe se dikush nuk mund të vijë këtu dhe të kërkojë pëlqime të caktuara pa qenë e urdhëruar më parë nga një institucion tjetër dhe ky është tani një shans për ata që duan të kritikojnë sinqerisht ata që janë përgjegjës dhe ata që drejojnë gishtin në komunën e Shtërpçës për arsye politike dhe se përgjegjësia e vetme është e autoriteteve qendrore dhe edhe tani po kërkojnë një mënyrë për të ndaluar punën e hidrocentralit.

Z. Vasiljevic përsëriti se komuna e Shtërpçës i ka marrë ato dy vendime të dëmshme dhe se këto nuk janë fjalët e tij, por vendimet e K K së Shtërpçës, me të cilat është njohur opinionin dhe se në bazë të këtyre dy lejeve, investitori më vonë ka marrë gjithçka që i nevojitej. Dhe sa i përket ligjshmërisë së atyre vendimeve, ato janë marrë në përputhje me ligjin, por ai ka qenë i mendimit se ato dy vendime janë politike, të cilat kanë shkaktuar dëme të mëdha për qytetarët e Komunës së Shtërpçës, natyrës etj.

Z. Jevtic është përgjigjur duke thënë se e di që ky raport i dhemb shumë disa njerëz dhe se nuk u përshtatet dhe se e din se disa kanë dashur që e gjithë barra t'i bartet komunës së Shtërpçës, por e vërteta është ndryshe. E pyeti pse dikush nuk i dërgon një letër Ministrisë kompetente dhe nuk i pyet pse nuk e ndalojnë funksionimin e hidrocentraleve, ai theksoi se askush nuk do ta bëjë këtë sepse nuk janë kundërshtarë të tyre politikë. Ai po ashtu tha se ky raport do të jetë në dispozicion

të qytetarëve dhe se personalisht është për largimit të menjëhershëm të atyre termocentraleve. Askush më nuk u lajmëruar për fjalë, dhe është kaluar në pikën e radhës.:

Shqyrtimi dhe miratimi i raportit gjashtëmuor të KKSB-së për vitin 2022, ku kryetari tha se KKSB-ja ka qenë shumë aktive në periudhën paraprake ku edhe qytetarët kanë pasur mundësi të marrin pjesë në punën e këtij Komitetit. Ajo që theksoi si të rëndësishme që u diskutua ishin protestat, siguria në komunikacion dhe shumë çështje të tjera. U arrit edhe një konkluzion që shpreh qartë qëndrimin për ndërtimet pa leje në Sevcë, ku KKSB pothuajse me njëzë e ka mbështetur këtë iniciativë, ku u kërkuar të mbrohen mbi të gjitha interesat e vetë qytetarëve. Në fund, ai tha se ky Komiteti do të vazhdojë të punojë për zgjidhjen e problemeve të caktuara me kohë, sepse interesi i qytetarëve është gjithmonë i pari.

Kryetari i Kuvendit më pas e ka qit në votim këtë pikë, e cila u miratua me 11 vota pro, 1 kundër dhe 2 abstenim. Më pas kaluam te pika e fundit e rendit të ditës, e cila është pika:

Të ndryshme, ku foli e para zonja. **Albina Hazizi**, e cila shprehu shqetësimin për një nxënës që ka mbaruar shkollën e mesme të mjekësisë dhe që nuk i lejohet të ushtrojë praktiken, madje nuk i është thënë pse është kështu dhe ka thënë se do të dëshironte të dinte pse kjo ndodh, sepse me sa di ajo, çdo nxënës ka të drejtën që të kryen praktiken tre mujore në Qendrën e Mjekësisë Familjare. Ajo gjithashtu bëri thirrje që këto qendra të vizitohen sa më shpejt për shkak të mungesës së barnave dhe tha se kjo duhet marrë seriozisht pasi të gjithë jemi të vetëdijshëm për rëndësinë kur kjo fushë është në pyetje.

Z. Shpejtim Arifi pastaj është lajmëruar për fjalë dhe ka thënë se në hyrje të ndërtesës së komunës është vendosur flamuri serb, e jo edhe e Kosovës dhe se kjo e ka shqetësuar. Ai ka përmendur edhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ku në kapitullin 1 të dispozitave themelore, neni 6.1. është për flamur, logoja dhe simbolet e Republikës së Kosovës, të cilat tregojnë multietnicitet, e ka përmendur edhe ligjin për vetëqeverisje lokale, 03/L-038 për përdorimin e simboleve kombëtare të Kosovës, ku thotë në kapitullin 2, përdorimi, vendosja dhe renditja e flamurit të Kosovës, neni 4. 1: Flamuri kombëtar vendoset brenda dhe jashtë institucionit. Ai kërkoj që të respektohet dhe zbatohet Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe ligji për përdorimin e simboleve shtetërore dhe atë sa më parë.

Fjalën e mori drejtori i shëndetësisë, **Marko Stanojevic**, i cili tha se sa i përket barnave, Drejtorja e Shëndetësisë furnizohet me barna në dy mënyra. Mënyra e parë janë barnat nga lista esenciale e ofruar nga Ministria e Shëndetësisë dhe furnizimi me këto barna është i rregullt, por ka barna që nuk mund të vijnë fare në territorin e Kosovës, për shkak të situatës aktuale që po ndodh gjithkund në bot. Një mënyrë tjetër furnizimi është se Ministria e Shëndetësisë ka një kontratë me kompaninë përmes së cilës blihen barnat dhe ku ne kishim një kontratë me ta para nja dy vitesh dhe ndoshta nuk ishte parashikuar mirë që do të përdoreshin barna të caktuara. në ndërkohë, dhe nuk ka pasur mundësi për blerjen e këtyre barnave, theksoi drejtori. Ai tha se kontratës ka skaduar afati dhe se ishte nënshkruar një e re dhe se ishte porositur një sasi më e madhe e barnave.

Kryetari i komunës tha se drejtori i Arsimit do ta jep me shkrim përgjigje lidhur me pyetjen për praktikën për shkak se ai mungon. Lidhur me çështjen e flamurit, kryetari i komunës iu përgjigj

z. Arifit, duke thënë se në intervistë e ka parë se ai do të ngrit kallëzim penal kundër tij, ku edhe vetë ka deklaruar se kishte probleme të tjera dhe se çështja e flamurit nuk ishte problem që do t'i interesonte qytetarët. Më tej ai tha se ishte habitur kur foli atë ditë, sepse kurrë nuk ka folur me mua, atë ditë tha gjëra që nuk ishin të duhura. Ai po ashtu tha se është shkelje e Kushtetutës kur dikush vendos vetëm flamurin e Shqipërisë në Kuvendin e Kosovës, kur bëhet betimi, në Prishtinë është vetëm flamuri Shqipërisë, e në komunat e tjera kemi vetëm flamur Shqipërisë, pra, shume gjëra këtu nuk i pëlqejnë as njerit dhe as tjetrit dhe se duke nisur një iniciative si kjo do te nise një gjë që ne vetëm do te harxhojmë energji, por nëse mendon se do te përfitojeni politikisht kjo është e drejta e tij, theksoi kryetari. Po ashtu ai tha se nuk do të frikësohet nga asnjë ankesë, se është këtu për të zgjidhur çështjet e qytetarëve që janë me rëndësi jetike, për t'u siguruar atyre kushte normale të jetesës dhe se z. Arifi duhet të mendon në atë drejtim.

Z. Arifi foli sërish duke thënë se kemi shumë probleme, por vendosja e flamurit nuk kërkon shumë punë dhe se nuk e di pse nuk është bërë deri më tani sepse nuk e sheh problem për një gjë të tillë dhe se është gjëja më e vogël që duhet bërë. Ai tha se nuk është këtu për të ngritur akuza dhe beson se kjo marrëveshje do të përfundojë pa ngritje e padis.

Z. Jevtic më pas e pyeti z. Arifi, a ka bërë kallëzim penal kundër tij?

Z. Arifi tha se nuk ka bërë padi sepse dëshiron që kjo çështje të trajtohet fillimisht këtu në Kuvend dhe përsëri ka përmendur se këtu të gjithë punojnë në institucion dhe se kudo që e obligon ligji dhe Kushtetuta e Kosovës, duhet. të respektohet, duke menduar për flamurin e Kosovës.

Kryetari i komunës tha z. Arifit se nëse ka njanjë paqartësi në të ardhmen, duhet të vijë tek ai për një bisedë para se të dalë publikisht me ndonjë gjë dhe se gjithmonë do të marrë një përgjigje të sinqertë.

Z. Arifi i është përgjigjur kryetarit duke i thënë se liria e shprehjes së lirë është e garantuar me Kushtetutë dhe se nuk ka nevojë për leje nga ai e as dikush tjetër për atë që thotë në publik.

Më pas **kryetari i komunës** falënderoi të gjithë për punën e tyre që morën pjesë në seancë, pastaj theksoi se është i gatshëm të bisedojë me të gjithë njerëzit me qëllim të mirë për çdo temë dhe se të gjithë ne të pranishmit kemi përgjegjësinë se si do t'i menaxhojmë marrëdhëniet në shoqërinë e sotme dhe se të gjithë ishin dëshmitarë të një diskutimi të nxehtë dhe se ai është gjithmonë aty për të mbrojtur të vërtetën. Ai po ashtu tha se mundohet që seancat t'i bëjnë sa më efikase dhe që qytetarët ta shohin një institucion që merret me zgjidhjen e problemeve të tyre dhe se ai do të vazhdojë të punojë në të. Z. Slavisa Vasiljevic, siç ka thënë edhe vetë, ka pasur shqetësim me ndërhyrjen e policisë, ka thënë se ka folur me të dhe ka marrë informacion se nuk e di pse ka ndodhur, por që sigurisht është tronditëse kur policia hyn në shtëpinë e dikujt në atë mënyrë. Dhe ajo që e pengojë, ishte se kur ka pasur protesta këtu dhe kur kemi pasur paragjykime për veprimet e mëparshme, jo të gjithë kanë qenë gjithmonë solidarë në këtë, dhe ai mendon se ne të gjithë duhet të jemi solidarë dhe se nuk duhet të bëjmë dallime dhe se mënyra në të vilen ne do të reagojmë në situata të caktuara është mënyra se si njerëzit sillen kur i ndodh dikujt tjetër dhe këtu tregojmë madhështinë tonë. Ai theksoi se do të bisedojë me ministrin dhe drejtorin e policisë për t'i shpjeguar pse ndodhi kjo dhe theksoi se njësoj do të kishte reaguar nëse

nuk do të ishte këshilltar por qytetar. Ai vazhdoi duke thënë se këtu në komunën tonë nuk kemi kriminelë apo vrasës të tillë që njerëzit të trajtohen kështu dhe se kur ndodh diçka të gjithë duhet të mendojmë pse ka ndodhur dhe të mos e injorojmë sepse nuk na ka ndodhur neve. Atë e shqetësonte fakti që asnjë nga gazetarët nuk tha asgjë kur kanë hyrinë TV HERC dhe as nuk kanë pyetur pse ndodhi, por lajmërohen kur nuk kanë informacion të mjaftueshëm dhe se ajo është gabim dhe theksoi se për këtë arsye, ne duhet të jemi gjithmonë në anën të drejtësisë dhe së vërtetës, në anën të qytetarëve tanë, pavarësisht nga çdo angazhim.

Kryetari i Kuvendit, z. Predrag Grbic më pas mbylli seancën e gjashtë të rregullt të KK të Shtërpçës.

Procesmbajtësi
Staja Markovic

Kryesuesi i K.K.
Predrag Grbic